



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 korrik 2012
Nr. Ref.:AGJ 285/12

AKTGJYKIM

në

Rastin nr. K104/12

Parashtruesi

Esat Kelmendi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Gjykatës së Qarkut në
Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Esat Kelmendi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendim i kontestuar gjyqësor është Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, i 30 nëntorit 2011, që parashtruesit i ishte dorëzuar më 16 dhjetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë. Parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ]

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (1) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 25 janar 2012, Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
6. Më 30 janar 2012, Kryetari, caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues, dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 30 janar 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejme: KPM).
8. Më 11 korrik 2012, Gjykata shqyrtoi dhe votoi për rastin.

Përmbledhje e fakteve

9. Më 20 janar 2011, Rektorati i Universitetit të Prishtinës (në tekstin e mëtejme: Rektorati) i shqiptoi (Vendimi Nr. 178) parashtruesit masën disiplinore “ulje në pozitë” për shkak të shkeljes së Udhëzimit Administrativ 2003/2, d.m.th. të dispozitave lidhur me procedurën disiplinore dhe të kodit të mirësjelljes. Parashtruesi u ankua kundër këtij vendimi në KPM.
10. Më 18 mars 2011, KPM (Vendimi A 02/31/2011), miratoi ankesën e parashtruesit dhe i anuloi të gjitha masat procedurale lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, përkatësisht “uljen në pozitë”, dhe caktimin në vendin e punës “zyrtar i lartë për studime master dhe doktoratë në Fakultetin e Shkencave Sportive”. Më tej, KPM e obligoi Rektoratin që ta kthente parashtruesin, në afat prej 15 ditësh, në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës në përputhje me kontratën e tij të punës
11. Më 30 mars 2011, parashtruesi, e paralajmëroi Këshillin Drejtues të Universitetit të Prishtinës, dhe më 31 mars 2011, menaxherin e personelit se moszbatimi i vendimit të KPM-së është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L – 192 për KPM (në tekstin e mëtejme: Ligji për KPM).
12. Më 4 prill 2011, menaxheri i personelit, informoi parashtruesin se edhe Rektori i Universitetit të Prishtinës është informuar dhe se ata do ta njoftojnë parashtruesin për paralajmërimin e tij brenda afatit të paraparë ligjor.
13. Më 8 prill 2011, , parashtruesi e njoftoi KPM-në, se Rektorati në pajtim me nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-192 nuk është duke e zbatuar vendimin e KPM-së.
14. Më 14 prill 2011, , parashtruesi ushtroi propozim në Gjykatën Komunale në Prishtinë, në pajtim me nenin 15 të Ligjit Nr. 03/L-192, për përmbarimin e vendimit të KPM-së.
15. Më 18 prill 2011, KPM në pajtim me nenin 15.2 të Ligjit Nr. 03/L-192, njoftoi Kryeministrin, Kryetarin e Kuvendit dhe Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë se Rektorati nuk është duke e zbatuar vendimin e KPM-së.
16. Më 7 korrik 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (E. nr. 523/2011) refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarimin e vendimit të KPM-së. Gjykata Komunale në Prishtinë konkludoi se në përputhje me nenin 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit Nr. 03/L-008 për procedurën përmbarimore (në tekstin e mëtejme: Ligji për Procedurën Përmbarimore) vendimi i KPM-së nuk është titull ekzekutiv sa i

përket rikthimit në ven të punës, por në përputhje me nenin 13 të Ligjit për KPM. Vendimet e KPM-së do të ekzekutohen nga zyrtarët e nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës.

17. Më 13 korrik 2011, parashtruesi ushtroi kundërshtim kundër vendimit të Gjykatës Komunale.
18. Më 15 korrik 2011, parashtruesi bëri kërkesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Komunale në Prishtinë.
19. Më 27 korrik 2011, Këshilli Gjyqësor i Kosovës e njoftoi parashtruesin se hetimi disiplinor ndaj gjyqtarit kishte filluar.
20. Më 30 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Ac. nr. 647/2011) refuzoi si të pathemeltë kundërshtimin e parashtruesit dhe e miratoi vendimin e Gjykatës Komunale

Pretendimet e parashtruesit

21. Parashtruesi pohon si në vijim:

- i. Neni 13 i Ligjit Nr. 03/L-192 saktëson se Vendimet e KPM-së janë përfundimtarë dhe të ekzekutueshëm në procedurë administrative dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të KPM-së nuk e ndalon ekzekutimin. Në një vendim të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut konkludohet se vendimet e KPM-së në janë vendime administrative përfundimtare dhe se procedurat gjyqësore nuk e ndalojnë ekzekutimin e vendimit të KPM-së. Në këtë rast, Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut urdhëroi kthimin e parashtruesit në vendin e tij të punës (shih Vendimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut nr. 2010 – 07, të 8 qershorit 2011 në rastin: Blerim Rudi kundër EULEX-it).
- ii. Rektorati asnjëherë nuk më ka njoftuar, qoftë me shkrim apo gojarisht, për arsyet e moszbatimit të vendimit të KPM-së të 18 marsit 2011, edhe pse në përputhje me nenin 14 të Ligjit Nr. 03/L-192, fillimi i një procedure për konflikt administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimeve të KPM-së.
- iii. Në përputhje me nenin 15.1 të Ligjit Nr. 03/L-192, moszbatimi i vendimit të KPM-së nga personi përgjegjës në institucion paraqet

shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

22. Për më tepër, Parashtruesi pretendon se Vendimi i Gjykatës Komunale (E.nr. 523/2011 i 7 korrikut 2011), është arbitrar, sepse nuk bazohet në ligj dhe është në kundërshtim me mënyrën se si Gjykata Komunale në Prishtinë dhe Gjykatat tjera Komunale në Kosovë e kanë shqyrtuar vendimet e KPM në raste të njëjta. Në mbështetje të pretendimit të tij, se gjykatat e rregullta e kanë shqyrtuar vendimin e KPM si titull përmbarimor, Parashtruesi i referohet vendimit në vijim:

- a) Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenin 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2632/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- b) Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë (Shënim: i njëjti gjyqtar që e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim) e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2633/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- c) Më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2634/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- d) Më 14 janar 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë (Shënim: i njëjti gjyqtar që e refuzoi propozimin e parashtruesit për përmbarim) e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 1155/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- e) Më 21 janar 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit

- Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2778/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- f) Më 20 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 604/2011). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- g) Më 20 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008 dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 1070/2011). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
- h) Më 7 prill 2011, Gjykata Komunale në Klinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë. Gjykata Komunale konkludoi se vendimi i KPM-së është titull ekzekutiv dhe se ankesa ndaj vendimit të KPM-së nuk e ndalon përmbarimin (E. nr. 635/2010). Këtë vendim u miratoi edhe nga Gjykata e Qarkut në Pejë (Ac. nr. 158/2011, i 5 korrikut 2011).
23. Sipas mendimit të parashtruesit, “është e qartë që KPM i përgjigjet përkufizimit të një gjykate apo tribunali, siç përcaktohet me ligj, dhe bie nën fushëveprimin e nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së (shih sqarimin në udhëzimin e nenit 6 – Zbatimi i Konventës për të Drejtat e Njeriut – i cili përcakton që neni 6 gjithashtu zbatohet për fazat administrative të procesit gjyqësor) dhe nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës”.
24. Parashtruesi më tej pohon, që “KPM është i themeluar me ligj (Ligji Nr. 03/L-192) dhe nxjerr vendime të detyrueshme për palët (*shih*: rastin Sramek kundër Austrisë, 22 tetor 1984, ku GJEDNJ konstatoi se gjykata paraprake nuk ishte e pavarur me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit)”.
25. Sipas parashtruesit, nga kjo rrjedh se “edhe moszbatimi i vendimeve të KPM-së bie nën fushëveprimin e nenit 6 të Konventës”.
26. Përveç kësaj, gjoja, “vendimmarrja nga gjykatat e rregullta në çështje ligjore që janë tërësisht të njëjta dhe mos mundësia ose mos dëshira për ta krijuar një praktikë gjyqësore konsistente cenon rënd parimin e sigurisë juridike si një nga

parimet bazë të sundimit të së drejtës, prandaj, nuk ka dyshim që vendimmarrja në këto rrethana përbën shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së dhe nenit 31 të Kushtetutës (*shih*: Rasti Beian kundër Rumanisë, 30658/05, 2007, GJEDNJ)”.

27. Parashtruesi gjithashtu pohon, që me këto veprime, Gjykata Komunale dhe Gjykata e Qarkut padyshim kanë shkelur nenin 24 të Kushtetutës sepse, në situatë të njëjtë juridike, qytetarët nuk janë trajtuar njëjtë para ligjit dhe nuk kanë siguruar mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim, siç kërkohet me nenin 24 të Kushtetutës.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

28. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe në Rregullore të punës.
29. Gjykata përcakton së pari nëse parashtruesi është palë e autorizuar sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë që *“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”* Në këtë drejtim, kërkesa është dorëzuar në Gjykatë nga një individ. Prandaj, parashtruesi është palë e autorizuar, ka të drejtë ta ngrejë këtë rast në Gjykatë sipas nenit 113.7 të Kushtetutës.
30. Përveç kësaj, Gjykata përcakton që Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori Vendimin Ac. nr. 647/2011 më 30 nëntor 2011, kurse parashtruesi e mori atë vendim më 16 dhjetor 2011. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 25 janar 2012. Prandaj, parashtruesi e ka përmbushur afatin kohor për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, siç parashihet me nenin 49 të Ligjit.
31. Për më tepër, sipas nenit 12 dhe 14 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, pasi Gjykata e Qarkut në Prishtinë konsiderohet “si gjykatë e shkallës së fundit për të gjykuar për çështje që lidhen me përmbarimin”. Si rrjedhojë, parashtruesi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion sipas ligjit të Kosovës.
32. Përfundimisht, Gjykata përcakton që parashtruesi i ka përmbushur kriteret e nenit 48 të Ligjit: *“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”* Në këtë drejtim, Gjykata vëren që parashtruesi pretendon për shkelje të nenit 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit për procedurën përmbarimore, i cili në nënparagrafin b) thotë:

Neni 24.1: Tituj ekzekutiv janë:

[...]

b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative [...].Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

33. Pasi parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, pasi i ka përmbushur afatet kohore për të parashtruar kërkesë në Gjykatë, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike, dhe pasi e ka qartësuar saktësisht shkeljen e supozuar të të drejtave dhe lirive, duke përfshirë aktgjykimin që e konteston, Gjykata konkludon që parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur të gjitha kriteret për pranueshmëri.

Vlerësimi kushtetues i kërkesës

34. Gjykata duhet t'i shqyrtojë meritat e ankesës së parashtruesit, pasi ai i ka përmbushur kriteret procedurale për pranueshmëri.
35. Gjykata vëren që parashtruesi e konteston vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, të 30 nëntorit 2011, me të cilin u vërtetua vendimi i Gjykatës Komunale për të mos e përmbuar vendimin e KPM-së.
36. Gjykata vëren që më 18 mars 2011, KPM miratoi ankesën e parashtruesit dhe e urdhëroi punëdhënësin që ta ripunësonte parashtruesin si Sekretar të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës sipas kontratës së tij të punës (Vendimi A 02/31/2011). Vendimi i KPM-së ishte përfundimtar.
37. KPM u formua në shtator të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës, të 22 shtatorit 2001. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.
38. Detyrat dhe përgjegjësitë e KPM-së u ripohuan më vonë me nenin 101.2 [Shërbimi Civil] të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, [...]”*.
39. Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i miratuar nga Kuvendi më 15 korrik 2010, dhe me të cilin zbatohet neni 101.2 i Kushtetutës, përcakton në nenin 3: *“Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që*

rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës". Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.

40. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që vendimet e KPM-së janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme në procedurë administrative dhe se ankesa e ushtruar kundër vendimit të KPM-së sipas nenit 13 të Ligjit për KPM-në nuk e ndalon ekzekutimin e vendimeve të tilla. Shih SHTOJCËN e këtij AKTGJYKIMI.
41. Pavarësisht këtyre dispozitave juridike, më 30 nëntor 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 647/2011, e vërtetoi vendimin e Gjykatës Komunale të 7 korrikut 2011, dhe ishte konkluduar se në përputhje me nenin 24 [Titulli ekzekutiv] të Ligjit për procedurën përmbarimore, vendimi i KPM-së nuk ishte titull ekzekutivi vlefshëm për ripunësim.
42. Në bazë të fakteve të mësipërme, Gjykata konsideron që parashtuesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion sipas ligjit të Kosovës për përmbarimin e vendimit të KPM-së. Sidoqoftë, përkundër përpjekjes së tij, vendimi i KPM-së nuk ishte zbatuar as nga Rektorati i Universitetit të Prishtinës, as nga gjykatat kompetente, siç u kërkuar nga parashtuesi dhe siç parashihet me Ligj.
43. Sipas shënimeve të Gjykatës, në rastin në fjalë, vendimi i KPM-së, që ishte përfundimtar dhe i detyrueshëm, mbetet i papërmbaruar për shkak se Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe gjykatat kompetente, që është dashur ta përmbaronin vendimin e KPM-së sipas kërkesës së parashtuesit, e kanë injoruar detyrën e tyre ligjore sipas ligjeve të zbatueshme të Kosovës, duke shkelur kështu parimin e sundimit të së drejtës, që është baza e rendit juridik të Kosovës. Të gjitha obligimet që dalin nga vendimet e KPM-së, prodhojnë efekte juridike për institucionet e tjera përkatëse, ku statusi i punëtorit rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Vendimi i këtij institucioni është vendim përfundimtar administrativ dhe, si i tillë, duhet të përmbarohet nga gjykatat kompetente siç propozohet për t'u përmbaruar nga kreditori lidhur me realizimin e të drejtave të tij të fituara në procedurën administrative.
44. Rasti në fjalë ngre çështjen sipas nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe neni 32 (e Drejta për Mjete Juridike) të Kushtetutës, sipas të cilit çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike. Rektorati i Universitetit të Prishtinës dhe gjykatat kompetente duke mos zbatuar vendimin e KPM-së, kanë shkelur nenin 31 dhe 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 dhe 13 të Konventës Evropiane.

45. Sundimi i ligjit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike dhe presupozon respektimin e parimit të sigurisë juridike, sidomos në lidhje me vendimet gjyqësore që janë bërë përfundimtare dhe të përmbarueshme. Asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rishikimin e një aktgjykimi përfundimtar dhe detyrues vetëm për qëllim të fitimit të një rishqyrtimi dhe vendimi të ri të rastit (shih, *mutatis mutandis*, Sovtransavto Holding kundër Ukrainës, nr. 48553/99, paragrafi 72, GJEDNJ 2002-VII). Po të mos ishte kështu, anulimi i vendimeve përfundimtare do të rezultonte në një klimë të përgjithshme të pasigurisë juridike, duke zvogëluar kështu besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe, si rrjedhojë, edhe në sundimin e të drejtës. Prandaj, organet kompetente kanë për obligim pozitiv që ta organizojnë një sistem për zbatimin e vendimeve, i cili është efektiv në kuptimin ligjor dhe atë praktik, dhe i cili siguron zbatimin e tyre pa vonesa të panevojshme (shih, Pecevi kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 21839/03, 6 nëntor 2008; Martinovska kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 22731/02, 25 shtator 2006).
46. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu konsideron që rasti në fjalë duhet të kuptohet si rast që ngre çështje sipas nenit 54 të Kushtetutës, i cili thotë: *“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”*.
47. Gjykata vëren se është e drejtë e palës për të filluar procedura gjyqësore në rast të dështimit për të realizuar të drejtën e fituar, siç definohet në nenin 31 dhe nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ. Do të ishte e pakuptimtë nëse sistemi juridik në Republikën e Kosovës do të lejonte që një vendim përfundimtar gjyqësor të mbetet i paefektshëm në dëm të një pale.
48. Prandaj, jo-efikasiteti i procedurave dhe mos-përmbarimi i vendimeve prodhon efekte që sjellin në situata që janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, një parim që autoritetet e Kosovës janë të obliguara ta respektojnë (shih Vendimi i KEDNJ në rastin Romashov v. Ukraine, parashtresa nr. 67534/01 Aktgjykimi i 25 korrikut 2004).
49. Duke dështuar që ta zbatojnë vendimin e KPM-së të 18 marsit 2011, organet përkatëse ua kanë hequr të gjitha efektet e dobishme dispozitave të nenit 31 të Kushtetutës dhe të neneve 6 dhe 13 të KEDNJ-së.
50. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që është shkelur e drejta për gjykim të drejtë dhe efektiv, siç garantohet me nenet e sipërpërmendura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.

51. Përveç kësaj, parashtruesi ankohet se janë shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, si dhe neni 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe neni 14 [Ndalimi i diskriminimit] i KEDNJ-së, pasi Gjykata e Qarkut në Prishtinë nuk e trajtoi parashtruesin në mënyrë të barabartë para ligjit me rastin e marrjes së vendimit në rastin e tij.
52. Në këtë drejtim, nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi, Gjykata vëren se gjykatat e rregullta në Kosovë i kanë konsideruar vendimet e KPM-së përfundimtare dhe të ekzekutueshme dhe e kanë obliguar punëdhënësin që ta ripunësonte punëtorin në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008, dhe me nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192.
53. Megjithatë, në rastin e parashtruesit, i njëjti gjyqtar që e refuzoi propozimin e parashtruesit për ekzekutimin e vendimit të KPM-së më 29 dhjetor 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë e detyroi punëdhënësin ta kthente punëtorin në punë në përputhje me vendimin e KPM-së dhe nenin 28.1 të Ligjit Nr. 03/L-008, dhe nenet 13, 14 dhe 15.4 të Ligjit Nr. 03/L-192 (E. nr. 2633/10). Gjykata Komunale e konsideroi vendimin e KPM-së përfundimtar dhe të ekzekutueshëm.
54. Në këtë drejtim, GJEDNJ theksoi në rastin *Lithgov* se neni 14 i KEDNJ-së i mbron personat [...] që janë vënë në situata të ngjashme nga dallimet diskriminuese në trajtim (Lithgov dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Baashkuar, Aktgjykimi i 8 korrikut 1986, Seria A, nr. 102; (1986) 8 EHRR 329). Përveç kësaj, GJEDNJ theksoi në rastin *Fredrin* se, në mënyrë që kërkesa e parashtruesit të jetë e suksesshme, duhet të konstatohet, ndër të tjera, që situata në të cilën gjendet viktimja e supozuar mund të konsiderohet e ngjashme me situatën e personave që kanë pasur trajtim më të mirë (shih Fredrin kundër Suedisë, Aktgjykimi i 18 shkurtit 1991, Seria A, nr. 192; (1991) 19 EHRR 784).
55. Përveç kësaj, GJEDNJ thekson se është obligim i gjykatave ose organeve lokale të tregojnë dhe dëshmojnë se trajtimi i një rasti ndryshe nga rastet e tjera me rrethana të ngjashme duhet të mbështetet me prova, të jetë bindës dhe i arsyetuar mirë. Në këtë drejtim, GJEDNJ theksoi në rastin *Lithgov* se: [...] për qëllime të nenit 14, dallimi diskriminues në trajtim është diskriminues nëse ky dallim nuk ka arsye të objektive ose të arsyeshme, d.m.th. nëse nuk ndjek një synim legjitim.
56. Në këtë drejtim, Gjykata vëren që, në bazë të parashtrësës së parashtruesit, në të cilën i ka identifikuar disa vendime të gjykatave të rregullta që i kanë konsideruar vendimet e KPM-së përfundimtarë dhe të ekzekutueshëm në procedurë administrative (shih: Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2632/10, datë: 29.12.2010; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2633/10,

datë: 29.12.2010; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2634/10, datë: 29.12.2010; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 1155/10, datë: 14.01.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 2778/10, datë: 21.01.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 604/2011, datë: 20.12.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Prishtinë, E. nr. 1070/2011, datë: 20.12.2011; Vendimi i Gjykatës Komunale në Klinë, E. nr. 635/10, datë: 07.04.2011; dhe Vendimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, AC. nr. 158/2011, datë: 05.07.2011).

57. Në lidhje me ekzekutimin e vendimit të KPM-së, në Vendimin E. nr. 2632/10, të 29 dhjetorit 2010, Gjykata Komunale në Prishtinë thotë:

“ ...

I. Në bazë të propozimit të kreditorit Islam Krasniqi nga Prishtina, dhe dokumentit përmbartimorë – Vendimit të plotfuqishëm me shenjë A 02/128/10 i dt. 03.09.2010 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i cili është bërë i ekzekutueshëm me dt. 22.09.2010, PJESËRISHT LEJOHET PËRMBARIMI ndaj debitorit QKUK dhe e njëjta DETYROHET që kreditorin ta kthej në vendin e tij të mëparshëm të punës – Shef i Shërbimeve Teknike të QKUK-së në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi.

II. Gjykata për lejin e përmbartimit vendosi konform nenit 28.1 të LPP-së dhe neneve 13, 14 dhe 15 pika 4 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

“ ...”

58. Kurse në rastin e parashtruesit, e njëjta Gjykatë vendosi ndryshe, duke thënë që:

“ ...

Gjykata pas analizimit të propozimit për përmbartim dhe shkresave të lëndës gjeti se: me nenin 24 të Ligjit për procedurën përmbartimore janë parapa titujt ekzekutiv në bazë të së cilëve gjykata e cakton përmbartimin kurse me pikën b të po këtij neni parashihet, citojmë “vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është parapa diçka tjetër” andaj gjykata konstatoi se vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës A 02/31/2001 1 datë 18.03.2011 nuk paraqet titull përmbartimor sa i përket kthimit në vendin e mëparshëm të punës kurse me nenin 13 të Ligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës (Ligji Nr. 03/L-192) parashihet se “Vendimi i Këshillit paraqet vendim administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarë të nivelit

të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”.

...”

59. Në rastin *Beian* (shih *Beian* kundër Rumanisë, 30658/05, të 6 dhjetorit 2007), GJEDNJ konstatoi që shkalla e lartë e pabarazisë së aktgjykimeve të Gjykatës së Kasacionit në Rumani për të njëjtat çështje ligjore vetvetiu është në kundërshtim me parimet e sigurisë juridike, që është implicite në të gjitha nenet e Konventës dhe është njëri prej elementeve themelore të sundimit të së drejtës. Kjo pabarazi është bërë burim i pasigurisë juridike, duke dëmtuar besimin e publikut në gjyqësor. GJEDNJ konstatoi se kjo pasiguri ka pasur efekt precedent të privimit të parashtruesit nga mundësia për t'i gëzuar të drejtat e parapara me ligj, ndërsa njerëzit e tjerë në situata të njëjta i kanë gëzuar këto të drejta. GJEDNJ gjeti që ka pasur shkelje të nenit 6.1 të Konventës.
60. Në këto rrethana, Gjykata konstaton që Gjykata e Qarkut nuk i ka marrë parasysh vendimet e veta të mëparshme për ta kualifikuar dhe gjykuar rastin e parashtruesit në përputhje me vendimet e veta duke u bazuar në parimin e të drejtës për trajtim të barabartë, siç kishte vendosur më parë në raste me rrethana plotësisht të ngjashme si të rastit të parashtruesit.
61. Në këto rrethana, Gjykata, në pajtim me nenin 24 (Barazia para Ligjit) të Kushtetutës, konstaton që ky dallim diskriminues në trajtim përbën shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë para ligjit.
62. Në përgjithësi, Gjykata konstaton se të drejtat e garantuara, siq garantohen me nenet e lartpërmendura të Kushtetutës dhe të KEDNJ, janë shkelur dhe se vendimi përfundimtar përmbarimor i KPM, Vendimi A 02/31/2011 i 18 marsit 2011 duhet të përmbarohet.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese, në pajtim nenin 20 të Ligjit, dhe Rregullin 56 (1) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 11 korrik 2012, njëzëri

VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën si të pranueshme;
- II. TA SHPALLË të pavlefshëm Vendimin Ac.nr. 647/2011 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të 30 nëntorit 2011, i cili shkelë nenet 24, 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenin 6 në lidhje me nenin 13 të KEDNJ;
- III. TA KTHEJË Vendimin Ac. nr. 647/2011 të Gjykatës së Qarkut të 30 nëntorit 2011, në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për rishqyrtim në pajtim me Aktgjykimin e kësaj Gjykate, në përputhje me Rregullin 74(1) të Rregullores së Punës;
- IV. Në pajtim me Rregullin 63 (5) të Rregullores së Punës, Gjykata e Qarkut në Prishtinë duhet t'i dorëzojë Gjykatës Kushtetuese informata lidhur me masat e ndërmarra për të zbatuar këtë Aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese;
- V. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese; dhe
- VI. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani



SHTOJCA

Dispozitat përkatëse ligjore lidhur me procedurat për ekzekutimin e vendimeve administrative dhe gjyqësore

Ligji (Nr. 03/L-008) për procedurën përmbarimore

63. Në Republikën e Kosovës, rregullat ligjore, procedura zbatuese dhe siguria e vendimeve rregullohen me Ligjin për procedurën përmbarimore.

64. Neni 1 [Përmbajtja e ligjit]

“ ...

1.1 Me këtë ligj caktohen rregullat për procedurën e gjykatës sipas të cilës realizohen kërkesat në bazë të titujve ekzekutiv (procedura e përmbarimit), po qe se me ligj të posaçëm nuk është paraparë diçka tjetër.

1.2 Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për përmbarimin e vendimit të dhënë në procedure administrative dhe për kundërvajtje me të cilin është caktuar detyrimi në të holla, përveçse kur për përmbarimin e tillë është paraparë me ligj kompetenca e organit tjetër.

...”

65. Neni 24 [Titulli ekzekutiv]

“ ...

24.1 Tituj ekzekutiv janë:

- a) vendimi ekzekutiv i gjykatës dhe ujdia gjyqësore ekzekutive;*
- b) vendimi ekzekutiv i dhënë në procedurë administrative dhe ujdia administrative, po qe se ka të bëjë me detyrimin në të holla dhe po qe se me ligj nuk është paraparë diçka tjetër;*
- c) dokumenti noterial ekzekutiv;*
- d) dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument ekzekutiv.*

...”

66. Neni 26 [Përmbarueshmëria e vendimit]

“
...

26.3 Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimorë, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.

...”

67. Neni 294 [Shpërblimi i pagës në rast të kthimit të punëtorit në punë]

“
...

294.1 Propozuesi i përmbarimit që e ka parashtruar propozimin për kthim në punë, ka të drejtë të kërkojë që gjykata të nxjerrë aktvendim me të cilin do të caktojë se, debitori ka për detyrë që atij t’ia paguajë në emër të pagës shumë mujore që janë bërë të kërkueshme, nga dita në të cilën ka marrë formë të prerë vendimi e deri në ditën e rikthimit në punë. Me të njëjtin aktvendim, gjykata e cakton përmbarimin për realizimin e shumëve mujore të caktuara.

...”

Ligji Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

68. Neni 13 [Vendimet e Këshillit]

“
...

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të vendimit.

...”

69. Neni 14 [E drejta e ankesës]

“
...

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është

dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

...”

70. Neni 15 [Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të Këshillit]

“...

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.
2. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njofton me shkrim kryeministrin, dhe eprorin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.
3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.
4. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të fillojë procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t’ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.
5. Këshilli duhet të njofton me shkrim Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimet që nuk janë ekzekutuar.

...”

71. Gjithashtu duhet të vihet në pah se në Republikën e Kosovës, ndonëse nuk parashihet me ligj, është praktikë e rëndomtë nga gjykatat që të përdoret Forca Policore e Kosovës si mjet për ta detyruar përmbarimin e vendimeve përfundimtare.